



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/



REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME

Data/Date:

Nga/Od/From: Grupi Punues për Dëgjimet Buxhetore 2025-2027

Për/Za/To:

CC:

Tema/Subjekat/Subject: Raporti nga procesi i dëgjimeve publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore [KAB] 2025-2027

## RAPORTI

i dëgjimeve publike

### KORNIZËN AFATMESME BUHETORE (KAB) 2025-2027

Përgatitja e raportit është bërë duke u bazuar në nenin 13 paragrafi 2.3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administrat Të Hapur ne Komune. Në këtë raport mund të gjeni të dhëna që nga mbajtja e dëgjimit publik dhe mënyra e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve (formë fizike, elektronike dhe në takimin direkt).

Duke u bazura në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/175 të datës 29.05.2024, për të nxjerr në diskutim publik Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027 dhe neneve 14-21 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01 R. 006/10911-144, datë 30.04.2014.

*Linku në ueb-faqen e komunës:*

<https://kk.rks-gov.net/shtime/>

*Linku në rrjetin social Facebook:*

<https://www.facebook.com/officialKomunaShtime/>

Të gjithë banorët e fshatrave dhe lagjeve, drejtorë të shkollave, përfaqësues të shoqërisë cilivile si dhe përfaqësues të mediave, janë njoftuar me kohë.

Në këtë dëgjim me publikun për Kornizën Afatmesme Buxhetore [KAB] 2025-2027 parashihet evidentimi i kërkesave prioritare të banorëve të fshatrave, përfaqësueseve të lagjeve, shoqërisë civile mediave për ato projekte që ata i cilësojnë si më jetike për të rritur mirëqenien sociale dhe lehtësuar jetën e qytetarëve tanë.

odata e konsultimit	Data /Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	F	M	Numri i komenteve, kërkesave, sugjerimeve	Numri i kërkesës të pranuara
mi i drejtpërdrejtë me të është qytetarët e komunës së nes të organizuar nga stari i Komunës dhe grupi i për dëgjimet buxhetore	Nga : 13.06.2024 Deri më 20.06.2024	185	7	178	236	

*Të gjitha kërkesat e parashtruara në dëgjim publik janë pjesë e raportit.*

Vendi i takimit	Data	Ora
Në shkollat e çdo fshati të komunës së Shtimes	Nga: 13.06.2024 deri me 20.06.2024	Nga ora 16:00

Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2025	Statusi i kërkesës /sugjerimi i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)
<p>Të zhvillohet turizmi në vendin tonë, pasi që kemi bukuri natyrore të shumta në numër dhe duhet të kujdesemi për to. Duhet të rregullohet shtegu për ecje deri tek Ujëvarat e Mollopolcit, pasi që ne jemi me fat që e kemi atë pjesë dhe vizitorët mahnitën me bukurit e ati vendi, prandaj është e nevojshme të investohet.</p> <p>Pjesë tjetër në të cilën duhet investuar është edhe "Shpella e Imer Devetakut", pasi që nuk ka mundësi pa ndonjë interventim të shkohet deri tek ajo pjesë.</p> <p>"Shpella e Lakuriqëve", tek pjesa e Topillës ku gjatë luftës është përdorur edhe si spital, pra ka një vlerë të madhe historike pasi që ka lënë gjurmë, mirëpo është edhe atraktiv.</p>	<p><b>Behadin Rexhepi – Përfaqësues i Bjeshkatarëve "Vjosa":</b></p>	<p><b>Pjesërisht</b></p>	<p>Një pjesë e kërkesës është pranuar mirëpo jo e tëra pasi ka buxhet të mjaftueshëm</p>
<p>Shpresoj që buxheti sa i përketë pjesës së kulturës viteve në vijim të ketë rritje. Ne si grup i të rinjëve jemi shumë të kënaqur.</p>	<p><b>Besnik Brahimi – Përfaqësues i A.K.V "Ilirida",</b></p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	
<p>Të rregullohet trotuari nga shkolla deri në Belinc</p> <p>Shkolla duhet të rinnovohet, dyert, dritaret duhet ndrrohen po ashtu edhe nxemja duhet rregulluar.</p> <p>Duhet të bëhet një nënkalim për në Shkollë.</p>	<p><b>Naip Shatmani</b></p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	
<p>Fshati jonë ka nevojë për gjithçka duke filluar nga ujësjellsi, rrryma, ndriçimi, më së shumti ka nevojë për zhvillim të rinis, të punësohen pasi që kemi rini të shkolluar, po ashtu kemi nevojë që bujqit të subvencionohen me sera apo mini sera me mjeda të tjera bujqësore.</p>	<p><b>Ismet Fazliu</b></p>	<p><b>Pjesërisht</b></p>	<p><i>Nuk ka buxhet të mjaftueshëm</i></p>

	Kemi nevojë të urat në fshatin ton tē ndërtohen, kemi nevojë pér ndriçim në disa lagje. Si prioritet është lagjia “Balaj”, “Behaj”, “Smakaj”. Rruga “Milaim Beha”, ka nevojë pér mirëmbajtje.		
	Para shtëpis timë është vendosur pritorja pér autobus, mirëpo problem është pluhuri i cili po shkaktohet nga ndalja e autobusëve.	Arben Fazliu	<i>Nuk është pranuar</i>
	Kanalizimi në fshtin Carralevë nuk kemi, disa pjesë kanë mirëpo nuk mjafton. Ujë po ashtu nuk kemi. Kam bërë një kërkesë pér ndërtimin e një urë mirëpo akoma nuk është realizuar.	Halim Aliti	<i>Pjesërisht</i>
	Rruga e Zborcit tē rregullohet dhe ndriçohet.	Fazli Fazliu	
	Rruga “Balaj”, a është në buxhet pér vitin 2024? Nuk kemi ujë tē pijes.	Zenel Balaj	
	Të ndërtohet një fushë e sportit tek shkolla.	Besnik Beha	
.	Të rregullohet kanalizimi në rrugën “Balaj”	Lulzim Balaj	
.	Rryma është shumë e dobët. Kompania “Pastërtia”, tek mahalla Ilazi nuk e bënë mbledhjen e mbeturinave.	Hysri Hasani	

• Lagjia e “Gurëve”, ka nevojë për ndriçim dhe gjithashtu të bëhet emërtimi i lagjes pasi që nuk ka emër. Po ashtu në fshatin ton është i nevojshëm një park. Rruga Gllavicë-Koshare është prishur dhe ka nevojë përvitalizim.	Shaban Krasniqi	<b>Plotësisht</b>	
• A do të ketë projekt përvazhdimin e trotuarit deri në Koshare dhe ndriçimin gjithashtu?	Nuhi Hoxha	<b>Plotësisht</b>	
• Fusha e sportit e cila është ndërtuar në fshatin ton e ka bllokuar rrugën e arave tek pjesa bujqësore. Kanalizimi të rregullohet tek disa shtëpi pasi që nuk kemi, aneks i rrugës “Galica”, përball fushës, 120 metra, gjithashtu edhe asfaltim.	Fadil Hoxha	<b>Plotësisht</b>	
• Fusha e cila është ndërtuar nuk ka ndriçim. Nuk kemi transport përvudhëtar dhe është një problem i madh.	Halil Krasniqi	<b>Pjesërisht</b>	Sa i përketë transporti mund te bëjm një kërke
• Nuk janë hequr betonët tek fusha e cila është ndërtuar dhe tani rruga përvësira është bllokuar.	Gëzim Krasniqi	<b>Plotësisht</b>	

• Segmet i rrugës kryesore, përball shkollës të asfaltohet.	<b>Arton Hashti</b>	<b>Plotësisht</b>	
• Të vendosen tabela për mos hudhjen e mbeturinave. Dhe kam një pyetje sa i përketë një parku në fshatin ton kur pritet të bëhet dhe ku?	<b>Anila Hoxha</b>	<b>Plotësisht</b>	
• Është mirë që të bëhet një list e rrugëve të cilat duhet asfaltohet dhe të vendosen prioritetet.	<b>Nuhi Hoxha</b>	<b>Plotësisht</b>	
• Qent endacak janë një problem i madh përfmijët dhe banorët.	<b>Valmira Hoxha</b>	<b>Plotësisht</b>	

Oborrri dhe tortuari i shkollës të rregullohen.	<b>Milazim Guri</b>		
<p>Në rrugën “17 Shkruti”, aneks i kësaj rruge të rregullohen kanalizimi një pjesë 200 metra dhe po ashtu te shtrohet asfalt ose zhavorr.</p> <p>Kemi një parcelë në fshat të cilën ne banorët e njohim si “Vakaf”, ku është 16 hekter, në atë jesë po bëhen keqpërdorime të mëdha prandaj nëse mund të bëhet diçka që kjo pjesë të ruhet.</p>	<b>Visar Hamiti</b>		
Rruja “Kozhinca” të asfaltohet	<b>Sheq Elezi</b>		
Në rrugën “Agim Ramadani”, të rregullohet njëra pjesë e anës së lumit e cila nuk është betonuar (50 metra)	<b>Naim Ademi</b>		

• Kemi probleme me ujin pasi që uji po futet në oborre të shtëpive private, ne jemi në rrugën “Vellezrit Hyseni”	<b>Nazim Hyseni</b>	<b>Plotësishët</b>	
• Në rrugën “Agim Ramadani” të rregullohet ndriçimi	<b>Ekrem Ramadani</b>	<b>Plotësishët</b>	
• Rruga “17 Shkurti”, të zgjerohet dhe të bëhet një park tek fusha “Hajdarit”. Sa i përkete Drejtorisë së Bujqësisë a është ndar buxheti për subvencione në këtë drejtori?	<b>Nebih Maksuti</b>	<b>Plotësishët</b>	
• Të rregullohet kanalizimi i Zborcit i cili po del në lum pasi që nga aroma e keqe nuk mun të qëndrojm, në atë pjesë lumi të zgjerohet. Uji të pijshëm nuk kemi edhe pse jemi të lidhur në ujësjellës, të bëhet një projekt i ri. Rruga e cila po shtrohet nga Zborci, është mirë që të bëhen disa gypa, aty ku ka dalje pëe në ara.	<b>Adem Ramadani</b>	<b>Pjesërisht</b>	

<p>Dy rrugë të arave të shtrohen tek segment i rrugës “17 Shkurti”. Neriman Ismajli: Kanalet Kulluese në rrugën “Dëshmorët e Godancit”, deri tek shkolla janë të bllokuara prandaj duhet të hapen dhe të rregullohet kanalizimi po ashtu asfalti në atë pjesë ku është prishur të rregullohet.</p>	<p><b>Hyzer Mustafa</b></p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	
<p>“Besim Sopa”, rruga është shumë e ngusht dhe duhet të zgjerohet. Shkolla duhet të rinovohet pasi nga çatia e shkollës kur ka rrëshje pikë. Oborri i shkollës është pa rrëthoja dhe është e nevojshme të rrethekohet, po ashtu është i nevojshëm edhe rregullimi i oborrit. Si fshat kemi problem me energjinë elektrike, është shumë e dobët, po ashtu edhe shtyllat i kemi në gjendje shumë të keqe. Rruga “Gjergjaj”, “Hoxhë Sinani”, “Lagjia Hoxhaj”, të asfaltohen. Në fshatin ton po ashtu kemi probleme edhe me kanalizim. Kemi edhe një kërkesë tjetër fusha e sportit në fshatin Gjyrkoc duhet të dislokohet për shkak të zhurmave të cilat po krijohen deri në orët e vona. Ndriçimi në të gjithë fshatin.</p>	<p><b>Nazif Sadriu</b></p>	<p><b>Pjesërisht</b></p>	<p>Nuk ka buxhet të mjaftueshëm</p>
<p>Të dislokohet fusha e futbollit në fshatin Gjyrkoc.</p>	<p><b>Aziz Haxha</b></p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	

<p>Ruga “Arifi”, shtëpia nr: 93, kemi probleme me kanalizim, kur uji mblidhet komplet futet në shtëpi po ashtu në puse edhe në oborre, prandaj ky problem duhet sanuar sa më parë.</p> <p>Shkolla e fshatit ton fare nuk i ngjason një shkolle të rregullot prandaj duhet të bëhen renovime si në objekt ashtu edhe në oborr. Rryma në fshat është në gjendje shumë të keqë dhe të dobët.</p>	<p><b>Bajram Haxha</b></p>	<p><b>Pjesërisht</b></p>	
<p>Në rrugën “Fehmi Agani”, as nuk ka ndriçim dhe as trotuar (500m).</p> <p>Klasat në shkollë janë shumë të vogla për tu mbajtur mësimi, disa prej klasave janë të mykura dhe nuk mund të realizohet mësimi në ato klasa. Oborri i shkollës duhet rregulluar gjithashtu edhe rrrethojat e shkollës.</p>	<p><b>Liridon Krasniqi</b></p>	<p><b>Pjesërisht</b></p>	
<p>Tek familja “Haxha”, duhet të hiqet fusha e futbollit pasi që ka probleme me zhurmën e cila zhvillohet për çdo natë në atë fushë.</p> <p>Të asfaltohet rruga e cila fillon nga “Ibrahim Rugova”, deri tek rruga “Fehmi Agani”.</p> <p>Kanalizimi nuk është funksional në fshatin Gjyrkovic, tokat të cila janë toka bujqësore nuk mund të punohen si shkak i kanalizimit jo funksional.</p> <p>Rethoja e shkollës është prioritet.</p> <p>Nga rruga “Fehmi Agani”, deri tek rruga “Besim Sopa”, duhet të rregullohet ndriçimi.</p> <p>Ruga “Hoxhë Sinani”, ndriçim.</p>	<p><b>Rexhep Gashi</b></p>	<p><b>Pjesërisht</b></p>	

<p>Në rrugën e “Hoxhë Sinani”, në lagjen time pres që asfaltit të ju vendoset në shtresë e holl që të menjanoj prishjen më shumë. Kur ka vërvshime mblidhet uji i cili e ka gryyer asfaltin, atë shtrat të asaj proke të lumiut duhet ta mirëmbani, të bëhet një shtrat në mënyr që mos prishet më shumë. Trotuari dhe ndriçimi i rrugës “Hoxhë Sinani”, Rruga deri tek varrezat duhet të mirëmbahet dhe të vije në nivelin e duhur jo të lihet siç është.</p>	<b>Hysen Hoxha</b>	<b>Pjesërisht</b>	
<p>Të asfaltohet një segment i rrugës “Camëria”, po ashtu edhe kanalizimi të rregullohet në këtë rrugë. Shtyllat elektrike, të bëhet një kërkesë që të ndërrohen.</p>	<b>Ymer Bajrami</b>	<b>Pjesërisht</b>	
<p>Ambientin në të cilin është shkolla ka hapsirë të mjaftueshme prandaj është e rrugës që të bëhet një park ose një mini park. Te rregullohet kanalizimi në të cilin lidhet rruga “Camëria”, po ashtu nga Tranziti deri tek shkolla të rregullohet kanalizimi dhe trotuari. Rivitalizimi i rrugës “Camëria” dhe “Shefket Mhadini”</p>	<b>Basnik Aeferi</b>	<b>Plotësisht</b>	
<p>Të rregullohet ndriçimi në tërë fshatin si dhe të bëhet një park tek Xhamia në lagjen “Bislim Ndrecaj”</p>	<b>Shaban Muhadini</b>	<b>Pjesërisht</b>	<p>Duhet të bëhet caktimi i vendi të përbashkëtë për parkun</p>

	Në lagjen "Fazli Grajqefci", të bëhet trotuari dhe ndriçimi.	Përparim Asllani		
	Në lagjen "Anton Cetta" të rregullohet ndriçimi dhe të jetë adekuat, në rreugën "Shefket Muhadini", të bëhet një rreth rrotullim, trotuari të zgjerohet si dhe të mirëmbahen rrugët.	Arlind Misini	<b>Plotësisht</b>	
	Të mirëmbahet shkolla dhe të rregullohet, të shtrohet rruga e shkolla nga hyrja deri tek shkolla.	Betim Bajrami		
	Një kanalizëm të cilën e kam kërkuar tek lokal i dua të dijë a është në buxhet që të bëhet përkëtë vit apo jo ? Po ashtu edhe në lagjen "Neziraj", kemi nevojë për ndriçim dhe trotuar.	Mentor Neziraj	<b>Plotësisht</b>	

<p>Së pari e kam një pyetje për ju, Kulla e zonës a hyn më nivel të fshatit apo me nivel të Komunës?</p> <p>Oborri i kullë duhet rregulluar, shkallët po ashtu edhe kanalizimi.</p> <p>Shkolla e vjetër të hijet dhe në vend të saj të ndërtohet ndonjë fushë futbolli ose fushë për sporte të ndryshme. Gjërat publike është mirë që të rregullohen ku frekuenton fshati më shumë.</p> <p>Të bëhet një shteg për ecje tek Ujëvarat e Mollopolcit, është mirë që të hapet rruga dhe të bëhet më zhavorr.</p>	<b>Ismet Salihu</b>	<b>Pjesërisht</b>	
<p>Ne si fshat dhe ju si Komunë duhet të bëjëm më shurnë sa i përketë Kullës së Zonës operative të Noredimes, pasi që është bërë shumë pak. Të gjitha pjesët të cilat kanë mbetur pa rregulluar sikurse oborri, shkallët, kanalizimi duhet të rregullohen.</p> <p>Të bëhen plakata me emërtim sa i përketë pjesëve ku gjatë luftës janë shtrytëzar si spitale, shkolla.</p>	<b>Xhemajl Mujota</b>	<b>Pjesërisht</b>	
<p>Tek pjesa e shkollës është mirë që të bëhet një fushë e sportit, meqenëse pjesa e epërmë e ka një fushë të sportit kështu që është e nevojshme edhe këtu ta kemi një. Fusha e sportit është mirë që te jete e gjelbert dhe jo me beton. Po ashtu do të ishte mirë edhe një park të vogël të bëhet tek pjesa ku ne e quajm "Mbi mrize".</p>	<b>Shaban Salihaj</b>	<b>Pjesërisht</b>	

<p>Një park është i nevojshëm tek pjesa lart, po ashtu është i nevojshëm një trotuar deri tek fusha e sportit dhe ndriço ashtu është i nevojshëm një trotuar deri tek fusha e sportit dhë ndriçim kemi nevojë në atë pjesë.</p>	<p>Fadil Neziraj</p>	<p><b>Pjesërisht</b></p>	
<p>Në rrugën “Hamz Jashari”, të rregullohet ndriçimi. Po ashtu edhe një pyetje kur do t'i largoni trapat të cilët janë në rrugë. Cka po ndodh me Lumin tek pjesa ku janë sjellë disa kur dhe më nuk janë hequr? Pastrimi i Lumin kur do të bëhet?</p>	<p>Alban Neziraj</p>	<p><b>Pjesërisht</b></p>	<p>Do të shikojm sipas mundësive buxhetore</p>
<p>Vitin e kaluar kur keni qenë është dhënë një kërkesë që brenda këti viti të përfundoj trotuari prej shkoliës deri ka rruga Zona e Noredimës, desha të dijë deri keni arritur dhe kur do të përfundoj ?</p>	<p>Kosovar Roshaj</p>		
<p>Transporti për nxënësit. Kanalizimi i Kullës të bëhet dhe oborri të rregullohet. Shtrati i lumbit të rregullohet si dhe shtegu për ecje për tek ujëvarat. Shkolla e vjetër duhet të rënitet, pasi që nxënësit luajn në ato pjesë dhe mund të rrezikohen dhe të lëndohen.</p>	<p>Reshat Mujota</p>	<p><b>Pjesërisht</b></p>	

<p>Në rrugën “Maliq Hoxha”, kemi probleme me energjinë elektrike, është shumë e dobët kemi nevojë për një trafo pasi që edhe paisjet në shtëpi po prishen si shkak i energjisë së dobët.</p>	<b>Halil Lami</b>	<b>Nuk është marr</b>	<p>Mund të bëjm kerkesë KEDS dhe presion, por shume nuk kemi kompetenca</p>
<p>Tek pjesa e varrezave duhet të bëhet një parking po ashtu rruga për tek varrezat duhet të zgjerohet pasi që është tepër e ngusht. Kemi hapsirë diku afér 20 ari në mes të fshatit, është mirë që ajo pjesë të bëhet park për fshatinë ton pasi që kemi nevojë. Pritore e autobusit të vendoset. Kemi problem me kompanin “Pastërtia”, kalon kohë e gjatë dhe nuk vijnë që të marrin mbeturinat. Trotuari të vazhdohet nga kyqja tek rruga “Fejzullahu”, deri tek shkolla.</p>	<b>Behar Sejda</b>	<b>Pjesërisht</b>	<p>Pastërtia është Ndërrma regionale ku nuk ka kompetenca menaxheria</p>
<p>Në rrugën “Fejzullahu”, kemi nevojë për një zgjidhje të bëhet sa i përketë pjesës së trotuarit kur fëmijët shkojn në shkollë. Po ashtu kemi problem me lumin pasi që shtrati është ngushtuar dhe është i mbushur me pem e mbeturina, kemi nevojë për pastrim sepse gjatë verës në nuk mund të qëndrojm nga aroma e keqe.</p>	<b>Muhamed Fazliu</b>	<b>Plotësisht</b>	

<ul style="list-style-type: none"> <li>Të bëhet një park në mes të fshatit pasi që ne kemi nevoj për ecje, femërijët të luajn.</li> </ul>	<b>Bejtush Sejda</b>	<b>Nuk është marr</b>	Është bërë parku në një lokacion tjetër
<ul style="list-style-type: none"> <li>Të vendoset një pengesë në rrugën “Fejzullahu”.</li> </ul>	<b>Shqiprim Hyseni</b>	<b>Plotësisht</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>Në një segment në rrugën “Lasgush Poradeci”, nuk ka rrym, ujësjellës e as kanalizim.</li> </ul>	<b>Gerona Lami</b>	<b>Pjesërisht</b>	Sipas mundësive buxhet
<ul style="list-style-type: none"> <li>Të asfaltohet një segment i rrugës “Hysenaj”, (50 metra). Gjithashtu edhe “Ruga e kuqe”, ka nevojë të rregullhet pasi që është në gjendje shumë të keqe.</li> </ul>	<b>Blerim Hyseni</b>	<b>Pjesërisht</b>	

<p>Kanalizim nuk kemi tek rruga “Xhemshir Xhemshiri”. Po ashtu pengesat të cilat janë në rrugë duhet të hiqen.</p> <p>E kemi prronin ku kemi probleme prej tij pasi që në të shumtën e rasteve futet uji në oborre e deri mbrenda edhe në shtëpi, nëse ka mundësi me gypa ose ndonjë gjë të ndalohet pasi që është shqetësim për ne.</p>	<b>Jajush Ademaj</b>		<b>Plotësisht</b>
<p>Në rrugën “Mehdi Korani”, të vendosen një tabelë 7 ton pasi që kemi pengesë të madhe nga kamionët. Tek çeshmja nuk kemi ndriçim</p>	<b>Albert Hyseni</b>		<b>Plotësisht</b>
<p>Nuk kemi ndriçim as kanalizim po ashtu më nevoiten dhe dy shtylla për energji elektrike dhe një kabllo tek rruga “Avdesh Ademaj”</p>	<b>Afrim Hysenaj</b>		<b>Pjesërisht</b>
<p>Të rregullohen trotuarti dhe ndriçimi tek “Mehdi Korani”</p>	<b>Lulzim Hysenaj</b>		

	Te rruga "Lumi", të bëhet një urë e re pasi që ajo e cila është përmomentin nuk është e qëndrushme.	Sekol Rexhaj		
	Rregullimi i shtratit të proçkës, nëse mund të bëhet me beton ose m gurë. Po ashtu edhe çshqja e kanalizimit kam një pyetje, a ka ndonjë projekt të madh sa i përketë kanalizimit të rregullohet në tërë fshatin? Në shkollë nuk kemi ujë të pijshëm për nxënësit dhe po ashtu kur pritet të rregullohet shkolla.	Alban Rashiti	Pjesërisht	
	Tek Xhamia kemi probleme me mbulojën e Xhamis, a ka mundësi Komuna të na ndihmoj?	Nexhat Rashiti	Nuk është marr	
	Kanalizimi të rregullohet në rrugën "Nazim Bakiu", (250m). Po ashtu i kemi dy dëshmor, nëse ka mundësi të hapet rruga për tek përmendoret e tyre dmth tek dëshmorët "Nazim Bakiu", dhe "Qamil Osmani". Po ashtu të vendosen edhe tabelat e dëshmorëve pasi që na i kanë hequr.	Baki Hysenaj	Pjesërisht	Sipas planifikimit buxhetor

<p>Rivitalizim ne rrugën “Beqa” Në rrugën “Isuf Muharremi”, të rregullohet ndriçimi Pastrimi i Lumit në fshatin Petrovë Rivitalizimi i rrugës “Xhemshir Xhemshiri” Kanalizimi në rrugën “Xhemshir Xhemshiri” Rrugën “Haqif Hysenaj”, dhe rrugën “Avdush Ademaj”, të rregullohen kanalet atmosferike Kanali atmosferik, të rregullohet në lagjen Rashiti Të rregullohet një park i vogël në Lagjen Ademaj</p>	<p>Asllan Beqaj</p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	
<p>Salla e sportit nëse ka mundësi të bëni një shtytje që nxënësit të kenë ku të luajn. Drenazhën e disa arave, gjithashu gjatë rrugës ‘Lluga’, të bëhen cdhe kanalet e ujiteve. Reabilitimi i rrugës ‘Idriz Ajeti’, po ashtu është problem kanalizmi në këtë rrugë. Rrugë e arave të shtrohet: rruga e ‘Pejës; dhe rruga ‘Aziz Dugolli’. Një shesh të bëhet në shfatin Pjetërshticë tek shkronjat e UCK-së. Të rregullohet ceshinja tek shkolla, ti bëhet një mbulojë e të ketë një pamje më të mirë. Mirëmbajtja e varrezave në fshatin Pjetërshticë dhe në rrugën ‘Idriz Ajeti’, rehabilitim i trotuarit.</p>	<p>Berat Gashi</p>	<p><b>Pjesërsht</b></p>	
<p>Pjesa e pedonalet nëse ka mundësi të vazhdojë akoma. Të rregullohet rruga Davidovc-Rashincë pasi që është në gjendje të keqe dhe të investohet në ato qështje të cilat janë më prioritare. Tek parku i cili është bërë, pamja e telave të rrymës po i jep një pamje të keqe po ashtu nëse është mundësia ta bëni një telë më të trash që të mos rrezikohen</p>	<p>Arjan Qorrolli</p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	

<p>fëmijët, të bëni kërkesë në KEDS.</p>			
<p>Kam disa pyetje pér ju, shtrati i Lumin tē Shtimes deri ku ma mbërrij?      Kur do tē shtrohen rrugët dytësore në fshatin ton?      Shtegu që tē është nis a do tē vazhdohet deri në Gilavicë?      Kërkoj që tē hiqet zhavorri i cili është lënë në arën time nga pastrimi i lumit.      Tē bëhet ndriçimi nga fshati Davidovc deri në fshatin Rashincë.      Shtallën e dhive siç e njohim ne, është mirë tē hiqet dhe tē shëndrrohet në një park tē vogël.</p>	<p><b>Xhemajl Qorrolli</b></p>	<p><b>Pjesërisht</b></p>	<p>Sipas mundësive buxhet</p>
<p>Rruga “Cani”, ndriçim dhe trotuar. Dy rrugë tē cilat janë tē pa asfaltuara duhet rregulluar, rruga e bacit Arif edhe e Arlindit. Në rruga “Lami”, nevoitet ndriçim.      Rruga “Baqir Rushiti”, ndriçim dhe trotuar.      Rruga “Rexha”, tē rregullohet kanalizimi.      Rruga “Trimat e Lirisë”, deri në Muzeqine, ndriçimi dhe trotuari tē rregullohen.      Rruga “Qorrolli”, tē rregullohet trotuari.      Rruga “Bunaj”, “Ibrahim Kodraj”, tē rregullohet ndriçimi.      Rruga “Osman Qorrolli”, tē rregullohet ndriçimi.      Rruga “Burimi”, tē rregullohet ndriçimi.      Rruga “Musë Qorrolli”, tē rregullohet asfaltimi.</p>	<p><b>Bekim Canolli</b></p>	<p><b>Pjesërisht</b></p>	<p>Sipas mundësive buxhet</p>

<p>Tek shkolla në Dayidevc, Kur po i marrin fëmijët nga shkolla po bëhet një tolovi e madhe dhe në me makina po bllokohen në rrugë, nëse ka mundësi të bëhet një zgjidhje sa i përketë këtij problemi. Të bëhet një parking tek shkolla.</p>	<b>Nazif Rushti</b>	<b>Pjesërisht</b> <p>Në bashkepunim me Policinë do të mundohe të bëjmë një zgjidhje</p>	
<p>Kur do të ndërrohen bankat në shkollë dhe a do të lyhet shkolla nga brenda? Tualeti në shkollë është në gjendje të keqe si dhe kamerat e sigurisë në shkollë kanë rënë dhe nuk funksionojn.</p>	<b>Jon Haxhiu</b>	<b>Plotësisht</b>	
<p>Rivitalizimi i rrugës "Haxhiu", Asfalltimi i dy segmenteve të rrugës "Haxhiu", Asfalltimi i një segmenti në rrugën "Buna", Rregullimi i trotuarit ne rrugën "Qorrolli", "Regaj", dhe "Haxhiu"</p>	<b>Gëzim Haxhiu</b>	<b>Pjesërisht</b>	<p>Njëher do të shikojet prioritetet e pastaj edh rivitalizimi</p>

<p>Ujë të pijes nuk kemi në fshatin Reçak. Emërtimi i një rrugë dhe vendosja e numrave pasi që nuk kemi.</p>	<p><b>Heset Rashiti</b></p>	<p><b>Pjesërisht</b></p>	<p>Emërtimi I rrugëve bël përmes Kuvendit</p>
<p>Sa i përketë pjesës së ujit ku e tha edhe personi para meje, fshati është keq, rrjeti i ujësjellsit është në të gjithë fshatin mërëpo ujë nuk ka. Këtë çështje e kam ngritur edhe në asamble pë ashtu kam bërë kërkesë edhe tek ujësjelli, mërëpo përgjigjja e tyre ka qenë që për shkak të orëve të ujëmatësve të tre fshatra është ndërpren komplet. Së paku ju si Komuna duhet të bëni presion ujësjelli që të bëhet një zgjedje. Kërkesë tjetër është edhe rruga "28 Nëntori", kavalizimi i mështë funksional për të gjitha shtëpit, po ashtu edhe shtërat atmosferike, nga shtëpit larg vijnë nëpër rrugë, prandaj do të ishte mirë që kjo gjë të rregullohet. Rivitalisimi i rrugës "Elliam Eoker", kemi edhe një kërkesë ndërtimin e një urë pë fshatin Reçak</p>	<p><b>Adem Ramadani</b></p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	
<p>Nga Xhamia deri tek shtëpija e Minushit, kockat e trotuarit kanë rën te posht, prandaj do të iskte mirë që të rregullohen. Të zgjerohet pjesa e "15 Janarit", rruga ku ka mbetur e agusht.</p>	<p><b>Nexhmëdin Syla</b></p>	<p><b>Pjesërisht</b></p>	<p>Sipas mundësive dhe planifikimeve buxheto</p>

<p>Ruga nga Xhamia që shkon në Shtime nga Cesta, është ngushtuar, po ashtu në të njëjtën rrugë nevoitet edhe ndriçim. Po ashtu edhe urën të cilën më lart e përmendi Adem Ramadani, është mirë që kur të rregullohet ajo urë të bëhen edhe disa barriera.</p> <p>Ruga “15 Janari”, tek pjesa nér Kompleksin rrjedh një ujë, a mundet aj ujë të ndalet. Po ashtu edhe dy gropat të mbulohen tek Kompleksi.</p> <p>Ruga “Besa besë”, të rregullohet dhe ndriçimi tek “Ahmet Kaciku” dhe rregullomi i trotuarit.</p>	<b>Minush Brahimi</b>	<b>Plotësisht</b>	
<p>Për fshatin Reçak është i nevojshëm një park të rregullohet, mbrapa shkollës e kemi hapsirën ku ka mundësi të rregullohet aty. Njëkohësisht të rregullohet edhe rruga sepse është me shkallët janë shumë të papërshtatshme edhe më pas nxënësit nuk kanë nevoj të udhëtojn me kombi, pranë vend të shkallëve të rrafshohet.</p> <p>Është një rrugë e cila ka mbetur në gjysme, ku ndodhen disa ara, prandaj nëse është mundësia të bëhet rrugë e arave dmth të shtrohet.</p> <p>Vrella në fshatin Reçak të përdoret për ujitje.</p>	<b>Xhelal Ismajli</b>		
<p>Trotuari në Cest të rregullohet sepse ka mbetur keq, po ashtu edhe fshati Reçak si fshatrat e tjera ka nevojë për një park.</p>	<b>Nysret Zymeri</b>	<b>Plotësisht</b>	

• Lagjia “Shabani”, dritat dhe trottuari të rregullohen.	<b>Gazmend Ramadani</b>	<b>Plotësisht</b>	
• Parcila e cila gjindet tek varrezat, na e është thënë që do t'i bashkangjitet pjesës së varrezave, a mund të bëhet diçka sa i përketë këti drejtimi? Dhe nëse mund të bëhet rrëthimi i 5 hektarve tek varrezat.	<b>Musë Shabani</b>	<b>Pjesërisht</b>	Në këtë pronë ka probleme duhet të shikoj
• Kur të bëhen investime është mirë që nëse një pjesa ka nevoj për kanalizim së pari të bëhet kanalizimi e më pas shtrimi i asfaltit, lagjia “Kurti”, është e vëtmja pjesë në fshat ku nuk kemi kanalizim. Nëse ka mundësi të bëhet një park, unë mund të ju ndihmoj sa i përketë pjesës së projektimit dhe vendit, si opsjon e kemi një pjesë në lagjen “Kurti”. Parku mund të bëhet tek pjesa afër fushës së futbollit.	<b>Besart Aliu</b>	<b>Pjesërisht</b>	Sipas mundësive buxhet
• Rruga “Kurti”, ka nevojë për asfaltim dhe ndriçim. Kanalizimi duhet të hapet dhe të hiqen pjesët të cilat e kanë bllokuar pasi që si shkas i kësaj toka bujqësore po mbetën të pa punuara.	<b>Ismet Rifati</b>	<b>Plotësisht</b>	

• Shkolla e fshatit ton nuk i plotëson kushtet për fillim të procedurave të mësimit kur të fillojë mësimi në shtator, nëse është e mundur të bëhet një renovim sa më parë.	<b>Nexhmedin Mehmeti</b>	<b>Plotësisht</b>	
• Të bëhet parku me lodra në mes rrugës “Mehmeti” dhe rrugës “Shabani”.	<b>Adrian Shabani</b>	<b>Plotësisht</b>	
• Salla e edukatës fizike a do të përfundoj këtë vit? Po ashtu Shkolla duhet të rregullohet nga brenda, ndriçimi i fshatit nga shkolla në të gjithë fshatin. A planifikohet të zgjerohet rruha për në Carralevëdhe për në Pjetershticë.	<b>Ismet Sadiku</b>	<b>Pjesërisht</b>	Në procedurë e sipër
• Nga shkolla të rregullohet trotuari për shkak të nxënësëve të cilët vin në shkollë. Tek lagjia “Qëndresa”, ndriçimi të vazhdohet, dmth të përfundoj i téri ( Nga rruga “Sadri Badra”, deri tek shkolla 300m ).	<b>Idriz Mehmeti</b>	<b>Plotësisht</b>	

<ul style="list-style-type: none"> <li>Dy pengesa të vendosen për shkak të shpejtësis së automjeteve. Të ndahet një parcelë nga zona e pylltarisë për varreza. Të bëhet një sallon i të pameve, po ashtu ne si fshat kemi nevojë edhe për një fushë të futbollit, gjithashtu edhe një park.</li> </ul>	<b>Arsim Kadrija</b>	<b>Pjesërisht</b>	Do t'i shikojmë procedurën për ndarje të tokave
<ul style="list-style-type: none"> <li>Në lagjen “Gjinofc”, rryma nuk është ne nivelin e duhur, jemi të rrëzikuar nga rryma. Transporti për nxënësit. Në rrugën “Sokol Dauti”, trotuari duhet të rivitalizohet. Rruga “Sodllarit” duhet të bëhen disa rrugë të arave.</li> </ul>	<b>Mehdi Dauti</b>	<b>Pjesërisht</b>	KEDSI nuk është kompetencë e Komunë mund vetëm të bëjmë rëkërkeshë
<ul style="list-style-type: none"> <li>Në rrugën “Izri Sadiku”, 25 metra të rivitalizohet asfalti nga fundi i rrugës.</li> </ul>	<b>Ismajl Sadiku</b>	<b>Plotësisht</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>Rregullimi i kanalizimit në lagjen “Rifat Haliti”, vetëm tre shpija kanë mbetur pa kanalizim.</li> </ul>	<b>Gresa Bislimi</b>	<b>Plotësisht</b>	

<p>Dy pengesa të vendosen për shkak të shpejtësisë së automjeteve.</p> <p>Të ndahet një parcelë nga zona e pylltarisë për varreza.</p> <p>Të bëhet një sallon i të pameve, po ashtu ne si fshat kemi nevojë edhe për një fushë të futbollit, gjithashtu edhe një park.</p>	<b>Arsim Kadrija</b>	<b>Pjesërisht</b>	Do t'i shikojmë procedurën për ndarje të tokave
<p>Në lagjen “Gjinofc”, rryma nuk është ne nivelin e duhur, jemi të rrezikuar nga rryma.</p> <p>Transporti për nxënësit. Në rrugën “Sokol Dauti”, trotuari duhet të rivitalizohet.</p> <p>Rruga “Sodllarit” duhet të bëhen disa rrugë të arave.</p>	<b>Mehdi Dauti</b>	<b>Pjesërisht</b>	KEDSI nuk është kompetencë e Komunë mund vetëm të bëjmë rëkërkësë
<p>Në rrugën “Izri Sadiku”, 25 metra të rivitalizohet asfalti nga fundi i rrugës.</p>	<b>Ismajl Sadiku</b>	<b>Plotësisht</b>	
<p>Regullimi i kanalizimit në lagjen “Rifat Haliti”, vetëm tre shpija kanë mbetur pa kanalizim.</p>	<b>Gresa Bislimi</b>	<b>Plotësisht</b>	

Raporti është përgatitur nga:

**Gentiana Mehmeti**